VENDIM
Nr. 57, datë 15.10.2007

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË VEPRIMTARINË E DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA"

(Ndryshuar me vendimin nr. 62, datë 29.8.2008)

(i përditësuar)

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është:

a) përcaktimi i instrumenteve që sigurojnë ushtrimin në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme të veprimtarisë së degës së bankës së huaj;

b) vendosja e kufizimeve maksimale të ekspozimit ndaj disa prej rreziqeve në ushtrimin e veprimtarisë së degës së bankës së huaj;

c) përcaktimi i kërkesave dhe i detyrimeve mbi raportimet dhe dokumentacionin verifikues për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, që në vijim për thjeshtësi, në këtë rregullore, do të quhen "degë".

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar (më poshtë ligji "Për Bankën") dhe të nenit 57, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronjat "b" dhe "c", nenit 59, pika 8 dhe nenit 108, pika 2 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" (më poshtë ligji "Për bankat").

Neni 4

Përkufizime

Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë të njëjtin kuptim si në nenin 4 të ligjit "Për bankat", ndërsa termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

"Depozitë ekuivalente e kapitalit" (DEK-a) - është pjesa e kapitalit fillestar minimal të dhuruar dhe të paguar në para nga banka-mëmë, për ushtrimin e veprimtarisë nga dega e saj në Republikën e Shqipërisë, të cilën dega është e detyruar ta investojë në aktivet e përcaktuara në pikën 7 të nenit 59 të ligjit "Për bankat", sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë rregullore.

"Bankë-mëmë" - është banka e huaj, e licencuar për të ushtruar veprimtari bankare nga

autoriteti përgjegjës i vendit të huaj, të cilës i është dhënë e drejta nga Banka e Shqipërisë për të hapur një degë të saj në Republikën e Shqipërisë.

KREU II
INSTRUMENTET E ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT

Neni 5
Llojet e instrumenteve

Sigurimi i ushtrimit të veprimtarisë bankare dhe/ose financiare të degës në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme, si dhe përmbushja e detyrimeve të saj ndaj kreditorëve, bëhet nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të mëposhtme:

a) Garancive që ofron banka-mëmë për administrimin e rreziqeve të degës, sipas përcaktimeve të nenit 6 të kësaj rregulloreje.

b) Investimit të DEK-ës, sipas përcaktimeve të pikës 7, neni 59 të ligjit "Për bankat" dhe të dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 6
Garancitë e bankës-mëmë

Për administrimin e rreziqeve të degës, banka-mëmë mbështet veprimtarinë e degës nëpërmjet:

a) dhurimit të kapitalit fillestar, si edhe ruajtjes së niveleve të përshtatshme të DEK-ës, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje;

b) angazhimit zyrtar (me shkrim) përpara Bankës së Shqipërisë se garanton me aktivet e saj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë e degës në Republikën e Shqipërisë;

c) mbulimit të humbjeve financiare të degës gjatë një viti financiar, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit pasardhës;

d) zbatimit të standardeve më të mira të përgjegjshmërisë në drejtim, nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të procedurave të brendshme për ndarjen e qartë të përgjegjësive, të përcaktimit të mënyrave të raportimit, të adoptimit të politikave të qarta kontabël, si dhe nëpërmjet miratimit dhe vënies në zbatim të sistemeve dhe programeve të përshtatshme të kontrollit të brendshëm të veprimtarisë së degës;

e) zbatimit të plotë të kuadrit rregullativ mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;

f) dhënies së informacionit që i përket bankës-mëmë dhe që i nevojitet Bankës së Shqipërisë si autoritet mbikëqyrës i degës që vepron në Republikën e Shqipërisë.

Neni 7
Funksionet e investimit të DEK-ës

Investimi i DEK-ës ka për qëllim të sigurojë:

a) qëndrueshmërinë e gjendjes financiare të degës si rrjedhim i investimit të saj në aktive me cilësi të lartë dhe me rrezik të ulët;

b) kthyeshmëri të shpejtë në cash ose në ekuivalentet e cash-it, duke ruajtur vlerën e saj në rast të kalimit të degës në procedurë likuidimi;

c) mbrojtjen e depozituesve të degës dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj kreditorëve të tjerë, në rast se dega i nënshtrohet procedurave të likuidimit.

Neni 8
Madhësia e DEK-ës

1. Madhësia minimale e DEK-ës (kundërvlefta në lekë) duhet të jetë:

a) për dy vitet e para të veprimtarisë së degës, të paktën 50 për qind e kapitalit fillestar minimal të dhuruar dhe të paguar në para nga banka e huaj; dhe

b) në vazhdim, të paktën 90 për qind e kapitalit fillestar minimal të dhuruar dhe të paguar në para nga banka e huaj.

2. Në llogaritjen e madhësisë së DEK-ës nuk përfshihet shuma e rezervës së detyruar që dega mban pranë Bankës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 19 të ligjit "Për bankën".

Neni 9
Investimi i DEK-ës

1. Dega, pas marrjes së licencës, investon DEK-ën në të paktën një prej aktiveve të mëposhtme:

a) depozitë në Bankën e Shqipërisë me normë interesi të përcaktuar me marrëveshje midis tyre dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregulloren për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të punës së Bankës së Shqipërisë;

b) bono thesari dhe obligacione të emetuara nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë;

c) letra me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë.

2. Dega nuk lejohet në asnjë rast të investojë DEK-ën pranë bankës mëmë.

3. Dega investon aktivet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, pranë Bankës së Shqipërisë, në rast se ajo i nënshtrohet procedurave të likuidimit.

KREU III
EKSPOZIMI NDAJ RREZIQEVE

Neni 10
Kufijtë maksimalë të rrezikut

1. Për rrezikun ndaj të cilit ekspozohet për veprimtari të veçanta apo për të gjithë veprimtarinë e saj, dega, zbaton kufizimet e mëposhtme:

a) teprica e kredisë nuk tejkalon 70 për qind të totalit të aktiveve të saj në fund të tremujorit paraardhës.

b) ekspozimi ndaj një personi dhe/ose personave të lidhur me të nuk tejkalon 5 për qind të totalit të aktiveve të saj në fund të tremujorit paraardhës.

2. Dega është e detyruar të monitorojë dhe të sigurohet për respektimin e kufizimeve të ekspozimit ndaj rrezikut, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së saj.

3. Në rastet kur ekspozimet tejkalojnë kufizimet sipas pikës 1 të këtij neni, dega raporton menjëherë në Bankën e Shqipërisë. Njoftimi shoqërohet me propozimet për një plan masash dhe kohën e nevojshme për të rivendosur ekspozimet brenda kufizimeve të kësaj rregulloreje.

Neni 11
Administrimi i rrezikut të sistemit
(Ndryshuar shprehje në paragrafin e parë dhe shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 me vendimin nr. 62, datë 29.8.2008)

1. Në funksion të parandalimit dhe administrimit të rrezikut të sistemit që buron nga veprimtaria e degës në territorin e Republikës së Shqipërisë, kjo e fundit duhet të zbatojë të paktën një nga kufizimet e mëposhtme:

a) vlera mesatare e aktiveve të saj, për 2(dy) tremujorë rradhazi, nuk duhet të tejkalojë 6.25 për qind të totalit të aktiveve të sistemit bankar";

b) vlera mesatare e depozitave të saj, për 2(dy) tremujorë rradhazi nuk duhet të tejkalojë 6.25 për qind të totalit të depozitave të sistemit bankar.

2. Në rast se dega tejkalon kufizimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë njofton degën se në këtë rast ajo do t'i nënshtrohet kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës të zbatueshëm për bankat.

KREU IV
MBIKËQYRJA DHE RAPORTIMI

Neni 12
Masat mbikëqyrëse

1. Për zbatimin e kërkesave dhe të detyrimeve të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë vlerëson në mënyrë të vazhdueshme:

a) madhësinë e DEK-ës sipas pikës 1 të nenit 8 të kësaj rregulloreje;

b) cilësinë e aktiveve në të cilën është investuar DEK-a, sipas pikës 1 të nenit 9 të kësaj rregulloreje.

2. Në rast mosplotësimi të detyrimeve të pikës 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë zbaton dispozitat e parashikuara në nenet 74 deri 91, të ligjit "Për bankat" dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 13
Detyrimi për raportim
(Ndryshuar paragrafi i parë me vendimin nr. 62, datë 29.8.2008)

1. Në zbatim të kërkesave dhe detyrimeve të kësaj rregulloreje, dega raporton në Bankën e Shqipërisë respektivisht çdo muaj sipas formularit nr. 1 dhe çdo tre muaj sipas formularit nr. 2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

2. Dega raporton në Bankën e Shqipërisë në përputhje me Sistemin Raportues të Unifikuar, të miratuar nga Banka e Shqipërisë për degën.

3. Dega paraqet në Bankën e Shqipërisë, brenda muajit pasardhës, raportet financiare tremujore të bankës-mëmë:

a) raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit;

b) kapitalin rregullator (fondet e veta);

c) treguesin e kredisë me probleme ndaj totalit të kredisë;

d) treguesin e kredisë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator (fondet e veta);

e) treguesin e shumës së fondeve rezervë për humbjet nga kreditë ndaj kredive me probleme;

f) treguesin e aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve.

Neni 14
Dokumentacioni i degës

Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, dega është e detyruar të mbajë në selinë e

saj dhe të vërë në çdo kohë në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të nenit 55 të ligjit "Për bankat", si dhe:

a) një kopje të marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur ndërmjet bankës-mëmë dhe Bankës së Shqipërisë;

b) deklaratën e bankës-mëmë sipas pikës b të nenit 6 të kësaj rregulloreje;

c) raportet financiare tremujore më të fundit të bankës-mëmë;

d) raportin më të fundit të ekspertit kontabël të autorizuar për bankën-mëmë; dhe

e) vlerësimin e performancës së bankës-mëmë nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit (shoqëritë e rating-ut).

KREU V
Dispozita përfundimtare

Neni 15

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregullore, zbaton dispozitat e parashikuara në ligjin "Për bankat" dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 16
Dispozitë transitore

1. Të gjitha dispozitat e akteve nënligjore të tjera lidhur me mbikëqyrjen e degës, të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të vazhdojnë të zbatohen pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Degët ekzistuese të bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, janë të detyruara të plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, jo më vonë se 3 muaj pas hyrjes në fuqi të saj.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ardian Fullani

Formulari nr.1

FORMULARI I DEPOZITËS EKUIVALENTE TË KAPITALIT		
Nr.	Depozita ekuivalente e kapitalit (DEK-a):	Shuma
1.	Depozitë në Bankën e Shqipërisë me normë interesi të përcaktuar me marrëveshje midis tyre.	
2.	Bono thesari dhe obligacione të emetuara nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.	
3.	Letra me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë.	
	SHUMA	

Formulari nr.2

Kodi	MATJA DHE KONTROLLI I KUFIJVE TË RREZIKUT (në mijë lekë)	Shumat
1. 2. 3. 4. 5.	Totali i aktiveve në fund të tremujorit paraardhës Teprica e kredisë e tremujorit raportues Raporti tepricë kredie/totalit të aktiveve Kufiri maksimal i rrezikut 5 % i totalit të aktiveve në fund të tremujorit paraardhës Renditja e ekspozimeve	 70%
	Emri i përfituesit *	Shuma
1.		
2.		
3.		
etj.		

* raportohen personat dhe/ose personat e lidhur që tejkalojnë nivelit 5 %.